

L I G J
Nr.9128, datë 29.7.2003

**PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË FINANCIAR TË PILOTËVE FLUTURUES NË
PENSION**

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 135, datë 11.5.2009; nr. 10 353, datë 18.11.2010)
(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Qëllimi

(Shtuar paragraf me ligjin nr. 10 135, datë 11.5.2009; shfuqizuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 10 353, datë 18.11.2010)

Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë një trajtim financiar të pilotëve, që kanë fluturuar me avionë reaktivë e me avionë me helikë, në shtesë të pensionit të pleqërisë, të cilin e përfitojnë nga sigurimi shoqëror i detyrueshëm, në momentin e lindjes së të drejtës së përfitimit të këtij trajtimi.

Neni 1/1

(Shtuar me ligjin nr. 10 353, datë 18.11.2010)

Të njëjtat përfitime, të parashikuara nga ky ligj, për subjektet e treguara në nenin 1, i përfitojnë edhe:

- a) pilotët/technikët e Forcave të Armatosura, të cilët kanë fluturuar me helikopterë;
- b) pilotët/technikët e njësisë së transportit mjekësor me helikopter, të cilët kanë fluturuar me helikopterë;
- c) pilotët/technikët e repartit të helikopterëve të Policisë së Shtetit, të cilët kanë fluturuar me helikopterë;
- ç) pilotët/technikët e Gardës së Republikës, të cilët kanë fluturuar me helikopterë.

Neni 2

Baza e llogaritjes

(Shtuar paragraf me ligjin nr. 10 135, datë 11.5.2009; ndryshuar me ligjin nr. 10 353, datë 18.11.2010)

Paga referuese është bazë për llogaritjen e këtij trajtimi financiar të veçantë.

Me pagë referuese, për efekt të këtij ligji, kuptohet:

- a) për pilotët/technikët e Forcave e Armatosura, paga bazë për funksionin, plus shpërblimin për gradën, të njëzuar me pagën referuese të funksionit organik të ushtarakut aktiv, në të njëjtën detyrë me përfituesin, në çastin e lindjes së të drejtës për trajtim financiar të veçantë;

b) për pilotët/technikët e njësisë së transportit mjekësor me helikopter, paga e grupit, plus pozicionin dhe shtesat për fluturime, të njësuara me pagën referuese të funksionit organik të pilotit/technikut të kësaj njësie, në të njëjtën detyrë me përfituesin, në çastin e lindjes së të drejtës për trajtim të veçantë financiar;

c) për pilotët/technikët e repartit të helikopterëve të Policisë së Shtetit, paga bazë për gradë apo funksion, plus shtesën për natyrë të veçantë pune e shërbimi, të njësuar me pagën referuese të funksionit organik të pilotit/technikut, në të njëjtën detyrë me përfituesin, në çastin e lindjes së të drejtës për trajtim të veçantë financiar;

ç) për pilotët/technikët e Gardës së Republikës, paga bazë për gradë, plus shtesën për kushte të veçanta pune e shërbimi, të njësuar me pagën referuese të funksionit organik të pilotit/technikut, në të njëjtën detyrë me përfituesin, në çastin e lindjes së të drejtës për trajtim të veçantë financiar

Neni 3

Financimi dhe llogaritja e përfitimit

Efektet financiare që rrjedhin nga ky ligj përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Pagimi dhe caktimi i përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj bëhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Mënyra e llogaritjes së përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4

Kushtet e përfitimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 353, datë 18.11.2010)

Pilotët, të cilët kanë fluturuar me avionë reaktivë, avionë me helikë dhe helikopterë dhe që kanë plotësuar ose plotësojnë kushtet për pension pleqërie, përfitojnë, përveç pensionit të pleqërisë, një trajtim të veçantë financiar, në shtesë të pensionit, në masën:

1. 50 për qind të pagës referuese që ka pasur përfituesi në çastin e daljes në rezervë, lirim ose pension pleqërie:

a) kur piloti ka fluturuar me avionë reaktivë jo më pak se 12,5 (dymbëdhjetë vjet e gjashtë muaj) vite kalendarike;

b) kur piloti ka fluturuar me avionë me helikë dhe me helikopterë jo më pak se 16,5 (gjashtëmbëdhjetë vjet e gjashtë muaj) vite kalendarike.

2. 35 për qind të pagës referuese që ka pasur përfituesi në çastin e daljes në rezervë, lirim ose pension pleqërie:

a) kur piloti ka fluturuar me avionë reaktivë jo më pak se 8,5 (tetë vjet e gjashtë muaj) vite kalendarike;

b) kur piloti ka fluturuar me avionë me helikë dhe me helikopterë jo më pak se 12,5 (dymbëdhjetë vjet e gjashtë muaj) vite kalendarike.

3. 25 për qind të pagës referuese që ka pasur përfituesi në çastin e daljes në rezervë, lirim ose pension pleqërie, për funksionet aviondrejtues fluturues, qitës-radist, radist, teknik, fluturues bordi, me jo më pak se 15 vite vjetërsi në shërbim, pavarësisht nga koha e daljes në pension.

Neni 5

Shuma e pensionit

Shuma e pensionit të plotë të pleqërisë plus masën e trajtimit të veçantë financiar, sipas

këtij ligji, nuk mund të jetë më e madhe se 50 për qind e pagës referuese të pilotit fluturues, kur ka dalë në rezervë, lirim ose pension pleqërie.

Masa e trajtimit të veçantë të pilotëve fluturues indeksohet sa herë që indeksohen pensionet e pleqërisë.

Neni 6

Njësimi i funksioneve

(Shtuar paragraf me ligjin nr. 10 135, datë 11.5.2009; ndryshuar me ligjin nr. 10 353, datë 18.11.2010))

Kur funksionet organike, në çastin kur piloti fluturues ka dalë në rezervë, lirim ose pension pleqërie, nuk ekzistojnë më në strukturën e Forcave të Armatosura, Ministri i Mbrojtjes bën njësimin e tyre, për efekt të pagës referuese, me funksionet organike që ekzistojnë në Forcat e Armatosura, në çastin kur pilotit i lind e drejta e përfitimit të këtij trajtimi.

Kur funksionet organike, në çastin kur piloti/tekniku i njësisë së transportit mjekësor me helikopter ka dalë në pension pleqërie, nuk ekzistojnë më në strukturën e Ministrisë së Shëndetësisë, Ministri i Shëndetësisë bën njësimin e tyre, për efekt të pagës referuese, me funksionet organike, që ekzistojnë në çastin kur pilotit/teknikut i lind e drejta e përfitimit të këtij trajtimi.

Kur funksionet organike, në çastin kur piloti/tekniku i repartit apo seksionit të helikopterëve ka dalë në pension pleqërie, nuk ekzistojnë më në strukturën e Policisë së Shtetit apo të Gardës së Republikës, Ministri i Brendshëm, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit apo të Komandantit të Gardës së Republikës, bën njësimin e tyre, për efekt të pagës referuese, me funksionet organike që ekzistojnë në Policinë e Shtetit apo Gardën e Republikës, në çastin kur pilotit/teknikut i lind e drejta e përfitimit të këtij trajtimi.

Neni 7

Dispozita kalimtare

Pilotëve fluturues, që u lind e drejta për përfitimin e trajtimit të veçantë, sipas këtij ligji dhe përfitojnë njëkohësisht nga neni 12 i ligjit nr.8087, datë 1.3.1996 “Për sigurimin suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, kanë të drejtë të zgjedhin ndërmjet trajtimit të veçantë dhe pensionit suplementar të pleqërisë.

Neni 8

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 3 të këtij ligji.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3935, datë 14.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**